



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1084/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Beqir Zeneli anëtar i AAK-së, kandidat për asamble komunale në Gjakovë, paraqitur kundër anëtarit të komisionerit të vendvotimi Demë Hoxha nga rradhët të subjektit politik AAK-së, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor dhe manipulimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Beqir Zeneli, kandidat për kuvendin komunal në Gjakovë nga rradhët e subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Beqir Zeneli anëtar i subjektit politik Aleanca për Ardhmëria e Kosovës (AAK), konkretisht anëtar për asamble komunale në komunën e Gjakovës, në të cilën ai pretendon se në qendrën e votimit në fshatin Cernjan nr. 0207c gjatë numërimit të votave anëtar i komisionit i AAK Demë Hoxha votat e mia ia kanë dhënë kandidatëve tjetër, po ashtu edhe në qendrën e votimit në fshatin në Zhabel 0227C anëtar i komisionit nga radhët e AAK-së Bajram Salihu gjatë numrimit votat e mia ia ka bart kandidatëve tjetër. Parashtruesi i ankesës mendon se është manipulim me votat e tij.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit Beqir Zeneli nga komuna e Gjakovës se në fshatin Cernjan në qendrën e votimit me nr. 0207C, si dhe në fshatin Zhabel në qendrën e votimit me numër 0227C. PZAP-i, i vlerëson si të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse siç pretendon pala ankuese andaj në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartpërmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 1084/2013 më datën 06.12.2013



**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetekatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.